

Vendim nr. 161 datë 15.07.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, në datën 15.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (SH) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “2001” SH.P.K., përfaqësuar nga studio ligjore “T&N”, me avokate Liljana Hysenllari, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 5419, datë 16.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 597, datë 20.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2021-1162, datë 14.07.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 17, 41, 42 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “2001” sh.p.k. (*kërkuesja*) është krijuar në vitin 2006 si subjekt i së drejtës tregtare. Në vitin 2007 kërkuesja është pajisur nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me leje shfrytëzimi (rinovuar në vitin 2008 dhe vitin 2009) për mineralet e grupit 4, për një periudhë 10-vjeçare, duke iu dhënë e drejta për hapjen e një karriere në zonën e Fanit të rrethit Mirditë. Në vitin 2009 shoqëria “B.E.” *joint venture*, që ndërtonte rrugën Durrës-Kukës-Morinë, sipas kërkueses, ka ndërhyrë pa të drejtë në territorin objekt të lejes së saj minerare, duke shfrytëzuar rezervat gjeologjike, duke dëmtuar infrastrukturën dhe duke e penguar në aktivitetin e saj.

2. Në muajin prill 2009 kërkuesja i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga shoqëria “B.E.” *joint venture* si rezultat i ndërhyrjes së paligjshme në territorin e dhënë kërkueses me leje minerare. Në seancën e parë gjyqësore gjykata i ka lënë detyrë kërkueses, në cilësinë e palës paditëse, që të ndreqte të metat e padisë, të saktësonte vlerën e objektit të kërkesëpadi (shumën e dëmshpërblimit), si dhe të paguante vlerën përkatëse të taksës së padisë. Në seancën e radhës nga kërkuesja është paraqitur një kërkesë me shkrim për përjashtimin e saj nga pagesa e taksës së padisë, për shkak të pamundësisë financiare.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5419, datë 16.05.2013, ka vendosur kthimin e kërkesëpadi dhe akteve pa veprim, me argumentin se kërkuesja nuk ka plotësuar të metat e padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim të veçantë kërkuesja, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim në shkallë të parë.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 597, datë 20.11.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke arsyetuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vepruar drejt lidhur me kthimin e padisë dhe akteve dhe se kërkimet e palës paditëse nuk ishin të bazuara në ligj. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kërkuesja, duke kërkuar prishjen e vendimeve të dyja gjykatave të faktit dhe kthimin e çështjes për gjykim në shkallë të parë.

5. Rekursi i kërkueses është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.06.2014 me nr. çështje 11118-02350-00-2014 regj. themeltar. Kërkuesja, pas një pritjeje rreth 5 vjetë që çështja të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë, i është drejtuar Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*) me aplikimin 56080/19, ku ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, ndalimin e diskriminimit, cenimin e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm dhe cenimin e së drejtës për zgjidhje efektive.

6. Ndërkohë që çështja ishte për shqyrtim pranë GJEDNJ-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1162, datë 14.07.2021, në dhomën e këshillimit, ka

vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. Në vijim, GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 30.05.2023, ka vendosur se aplikimi i kërkueses është i papranueshëm, si në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, ashtu edhe për kohëzgjatjen e procesit, pasi shoqëria kërkuese e kishte pasur mundësinë për të paraqitur ankesat e saj pranë autoriteteve vendase.

8. Në datën 29.04.2024 (sipas shërbimit postar) kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 16.05.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 04.07.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkueses

9. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e:

9.1 *Së drejtës për proces të rregullt* në drejtim të:

9.1.1 *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi kthimi i akteve dhe mosgjykimi i çështjes i kanë mohuar të drejtën për t'u gjykuar dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për çështjen e tij. Pagesa e taksës për aktet, së pari, nuk ka autorizim kushtetues dhe ligjor për t'u paguar, duke qenë se kjo taksë nuk përcaktohet në ligjin për taksat kombëtare. Po kështu, edhe masa e kësaj takse duhej të ishte parashikuar në ligjin për taksat dhe jo me udhëzim. Për rrjedhojë, të tria gjykatat nuk kishin bazë ligjore për të detyruar paditësen të paguante një taksë të paparashikuar në ligj. *Së dyti*, të tria gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë faktin se kërkuesja kishte paaftësi paguese në kohën e paraqitjes së padisë, pasi aktiviteti i shoqërisë ishte i pezulluar për shkak të vështirësive financiare, si dhe rezultonte debitore ndaj organeve tatimore.

9.1.2 *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në recurs.

9.2 *Parimit të mosdiskriminimit*, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi me vendimet e tyre të tria gjykatat e kanë diskriminuar për shkak të gjendjes së saj ekonomike si pasojë e paaftësisë paguese.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuesses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessa të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

11. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuessa, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuessa përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate.

13. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuessa duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Kjo do të thotë se mbrojtja kushtetuese mund të kërkohe vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuessa i ka parashtruar pretendimet e saj në formë dhe përmbajtje në ankimet e paraqitura në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë nuk ka

mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Në këto kushte, konsiderohet se kërkesja ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret konstatohet se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkesja, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 14.07.2021, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 29.04.2024, pas pothuajse 3 vjetësh, pra dukshëm jashtë afatit ligjor 4-mujor. Kërkesja në ankimin kushtetues ka parashtruar se pasi u njoh me vendimmarrjen e GJEDNJ-së, mori dijeni se çështja në Gjykatën e Lartë ishte shqyrtuar. Për këtë arsye në datën 12.07.2023 i është drejtuar Gjykatës së Lartë për të kërkuar informacion lidhur me vendimmarrjen e saj. Pas informacionit të Gjykatës së Lartë se në datën 14.07.2021 ishte vendosur mospranimi i rekursit, kërkesja i është drejtuar edhe dy herë të tjera Gjykatës së Lartë. Konkretisht në datën 19.07.2023 dhe më tej, pas pothuajse 5 muajsh, në datën 27.12.2023, duke kërkuar vënien në dispozicion zyrtarisht të vendimit të arsyetuar. Me shkresën nr. 6757/1 prot., datë 28.12.2023, marrë nga kërkesja në datën 04.01.2024, Gjykata e Lartë i ka dërguar vendimin e kundërshtuar nr. 00-2021-1162, datë 14.07.2021. Bazuar në këto fakte kërkesja pretendon se ka marrë dijeni efektive për vendimin e kundërshtuar në datën 04.01.2024.

17. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i GJEDNJ-së është marrë në datën 30.05.2023. Në këtë vendim, në faktet e pranuar, evidentohet edhe rrethana se Gjykata e Lartë në datën 14.07.2021 kishte vendosur mospranimin e rekursit (*shih paragrafin 7 të vendimit të*

GJEDNJ-së). Nisur nga ky fakt, si dhe të kohës kur Gjykata (Kushtetuese) u bë operative (për shkak të procesit të *vetting*-ut) sipas GJEDNJ-së edhe pse mundësia praktike e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual u mundësua vetëm pas depozitimit të kërkesës (në GJEDNJ), shoqërisë ankuese iu kërkua që ta shteronte atë mjet (*shih paragrafin 16 të vendimit të GJEDNJ-së*). Gjithashtu, GJEDNJ-ja pohoi se në parashtrimet e saj të fundit në datën 28.02.2022 shoqëria nuk ka bërë të qartë nëse kishte paraqitur ankesë kushtetuese ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 17 të vendimit të GJEDNJ-së*). Po ashtu, rezulton se vendimi i GJEDNJ-së është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 111 të datës 27.07.2023.

18. Për qëllime të këtij shqyrtimi i është kërkuar informacion edhe Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Me informacionin e datës 30.05.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi nr. 00-2021-1162, datë 14.07.2021 i Kolegjit Civil është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 29.05.2024.

19. Bazuar në sa më lart, në kontekstin e rrethanave të çështjes në shqyrtim, edhe pse Gjykata e Lartë nuk e kishte publikuar në një kohë të përshtatshme vendimin e kundërshtuar të arsyetuar në faqen e saj zyrtare, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se referuar vendimit të GJEDNJ-së rezulton se kërkuesja kishte marrë dijëni efektive për vendimin e Gjykatës së Lartë që kishte vendosur mospranimin e rekursit të saj gjatë procesit në GJEDNJ dhe për më tepër me botimin e vendimit të GJEDNJ-së në Fletoren Zyrtare në datën 27.07.2023. Në këtë situatë, si dhe duke iu referuar kësaj date të fundit, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesja e ka paraqitur ankimin kushtetues individual tej afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë ajo nuk legjitimohet *ratione temporis* për t’iu drejtuar Gjykatës.

20. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimitimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të legjitimitimit të kërkueses bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash¹,

¹ Gjyqtarët Sonila Bejtja dhe Sandër Beci votuan për legjitimitimin *ratione temporis* të kërkueses, duke arsyetuar se data e marrjes dijëni efektivisht për vendimin e Gjykatës së Lartë duhet të konsiderohet data 04.01.2024, data kur kërkuesja ka marrë dijëni në rrugë shkresore për këtë vendim. Ky arsyetim bazohet në faktin se marrja dijëni

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk mundet kurrsesi të nënkuptojë referimin e GJEDNJ-së të ky vendim, por lidhet me marrjen dijeni në mënyrë efektive të tij, ndaj dhe do të duhet të shihet e lidhur jo vetëm me zbardhjen e arsytimit të vendimit, por edhe me njoftimin e tij në mënyrat e parashikuara nga ligji.